




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“SWISS PLUS - 1” SH.P.K.

Nr. i biznesit - 810166274

Pronar – Bujar BERISHAJ

Operator i Shpërndarjes “SWISS PLUS-1 SHPK”

Platforma: IPTV

Malishevë

Ref: 1906/684/LIC/ni

## VENDIM

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes, “SWISS PLUS-1 SHPK”, sipas platformës IPTV,  
me seli në Komunën e Malishevës

---

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Kandidati “SWISS PLUS-1 SHPK” ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë të shpërndarjes sipas platformës IPTV, më datën 16 maj 2019.

### Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
6. Komisioni, i ka ofruar kandidatit për licencë për operator të shpërndarjes “SWISS PLUS-1 SHPK” të gjitha aktet nënligjore për aplikim për licencë si: Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01), Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë dhe Formën për aplikim për licencë të KPM-së, për operator të shpërndarjes.
7. Komisioni vlerëson se kandidati “SWISS PLUS-1 SHPK”ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores KPM-2016/01 dhe të shtojcës së kësaj rregullore, ku përcaktohen Procedurat, Kushtet dhe Kriteret për Licencim.
8. Me Rregulloren KPM-2016/01 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator të shpërndarjes. Prandaj, Zyra Ekzekutive e KPM-se vlerëson se, një operator i shpërndarjes mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, ndërsa, kandidati “SWISS PLUS-1 SHPK”ka dorëzuar një listë prej 88 kanaleve, si pjesë e katalogut programor.
9. Kandidati “SWISS PLUS-1 SHPK”për operator të shpërndarjes sipas platformës IPTV, përveç ofruesve të shërbimeve programore të licencuara nga KPM, të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, do të ketë të drejtë të bartë në katalogun e tij programor vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit.
10. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator të shpërndarjes “SWISS PLUS-1 SHPK”mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në platformën IPTV, dhe mund të zgjerojë katalogun e programeve në të ardhmen. Kandidati “SWISS PLUS-1 SHPK”obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
11. Komisioni vlerëson se, kandidati “SWISS PLUS-1 SHPK”ka dorëzuar aplikacionin e tij në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren KPM-2016/01 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/06, për t’u pajisur me licencë të KPM-së për një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes.
12. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor “SWISS PLUS-1 SHPK”ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

### VENDIM

13. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 17 qershor 2019, merr vendim që kandidatit “SWISS PLUS-1 SHPK”i cili planifikon të operojë në disa fshatra të Komunës së Malishevës, t’i lëshojë licencën e KPM-së për operator të shpërndarjes sipas platformës

IPTV, për të ofruar shërbime të programeve në pajtim me katalogun e ofruar programor sipas marrëveshjeve për të drejtat autoriale të atyre shërbimeve mediale audiovizuale.

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
\_\_\_\_\_  
Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.06.2019

datë